



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr.53, Datë 29.10.2007

“PËR DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË SË TIRANËS NË MBËSHTETJE TË V.K.M NR. 434 DATE, 13.07.2007 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 551, DATE, 07.11.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE E PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR .

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32/ç të ligjit Nr. 8487, datë 13.05.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të Ligjit Nr.8935, datë 12.09.2002, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.8487 datë 13.05.1999 ”Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, neni 6, gërma a, gërma b dhe germa c të Ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999, “Statusi i Nëpunësit Civil”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.434 datë 13.07.2007, “Për disa ndryshime në vendimin Nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore, për efekt page dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nivelet e pagave për punonjësit civilë në Bashkinë e Tiranës sipas lidhjes Nr.1, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Të miratojë nivelin e pagës të punonjësve më kontratë sipas lidhjes nr.2, bashkëlidhur këtij Vendimi.

3. Të miratojë shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.
4. Efektet financiare të këtij Vendimi fillojnë më 1 korrik të vitit 2007 dhe të përballohen nga fondet e e planifikuara për rritjen e pagave në buxhetin e këtij viti.
5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.39, datë 17.07.2006 “Për nivelin e pagave në Bashkinë e Tiranës “, shfuqizohet.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R